REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E DIASPORËS / MINISTRY OF DIASPORA / MINISTARSTVO ZA DIJASPORU
Njësia Org. / Org.Jedin / Org.Unit: 01 — Nr.Prot. / Br.Prot / Prot.No.: 280
Nr. i faqeve / Broj.strana / No.pages: 01 — Data / Datum / Date: 03.07.2013
Prishtinë / a

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

## Qeveria - Vlada - Government

## Ministria e Diasporës - Ministarstvo za Dijasporu - Ministry of Diaspora

## Kabineti i Ministrit - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister

Nr. _____/2013
Datë: 03.07.2013

Në mbështetje të nenit 93 (paragrafi 4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 3) dhe neni 6 (paragrafi 1.4) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011) dhe Rregulloren nr. 07/2011 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 02/2011, si dhe në pajtim me nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-095 për Diasporën dhe Mërgatën si dhe në pajtim me nenin 3 të Rregullores Nr. 01/2012 për kriteret dhe mënyrën e ndarjes së Çmimit vjetor të Diasporës dhe Mërgatës për grupin apo mërgimtarin më të suksesshëm gjatë vitit, Ministri i Ministrisë së Diasporës nxjerr këtë:

## VENDIM

I. Emërohet Komisioni për ndarjen e Çmimit Vjetor të Diasporës dhe Mërgatës për grupin apo mërgimtarin më të suksesshëm gjatë vitit si dhe Çmimit *Post Mortem*, në këtë përbërje:

1. Flora Brovina, veprimtari humanitare – Kryesuese;
2. Ymer Avdiu, Ministria e Diasporës –anëtar;
3. Begzad Baliu, Instituti Albanologjik, Prishtinë – anëtar;
4. Saxhide Mustafa, RIINVEST – anëtare;
5. Xhemshir Haziri, përfaqësues nga diaspora – anëtar;
6. Besim Hasani, Komiteti Olimpik i Kosovës – anëtar;
7. Liridon Zeqa, Ministria e Diasporës – anëtar.

II. Komisioni ka për detyrë që të ndajë Çmimin Vjetor nga neni I, në fushat e përcaktuara me nenin 2 të Rregullores Nr. 01/2012 për kriteret dhe mënyrën e ndarjes së Çmimit vjetor të Diasporës dhe Mërgatës për grupin apo mërgimtarin më të suksesshëm gjatë vitit.

III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

---

Vendimi u dorëzohet:

- Kabinetit të Kryeministrit
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit të MeD-së

Ibrahim Makolli - Ministër